



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 166, datë 21.12.2012

**PËR
LICENCIMIN E AGJENTËVE TË SIGURIMIT TË JO-JETËS NË EMËR DHE
PËR LLOGARI TË SHOQËRISË “INSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6, shkronja dh, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të nenit 81, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e agjentëve në sigurime të Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit ”Insig” sh.a., sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Licenca jepet me afat 3 vjet.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI